



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VI**

**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 07

Prishtinë, më 8.11.2017, në ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Valon Ramadani, Fisnik Ismaili, Imet Rrahmani, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Munguan: Jasmina Zhivkoviç dhe Arban Abrashi.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit: OSBE, SPRTK, EU EON, INPO, GAP, Radio Kosova.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit, me këtë

Rend të ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Diskutim lidhur me nismën legislative për hartimin e Projektligjit për Radiotelevizionin e Kosovës;**
- 3. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

- 2. Diskutim lidhur me nismën legislative për hartimin e Projektligjit për Radiotelevizionin e Kosovës**

**Nait Hasani**, kryetar i komisionit, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, propozoi që komisioni të përcaktohet për të përzgjedhur një model të një transmetuesi publik, ngase çështje kryesore për projektligjin janë prona, financimi dhe përzgjedhja e anëtarëve të bordit.

Ai, gjithashtu, njoftoi komisionin se ka kërkuar nga RTK një përgjigje lidhur me çështjet në fjalë apo ndonjë propozim, po që se kanë.

Si model të përfaqësues për Projektligjin për RTK-në, propozoi të merret modeli i një shteti nga ato vende që janë anëtare në BE, Austria, Sllovenia apo Kroacia.

**Milaim Zeka**, tha se RTK duhet të ketë pronën e vet, ndërsa parapagimi duhet të rregullohet në formën, ashtu siç e kanë vendet perëndimore. Se a do të procedohet projektligji, kjo varet nga vullneti politik.

**Xhevahire Izmaku**, pyeti për programin e punës lidhur me procedurat e projektligjit dhe propozoi që gjatë hartimit të draftit të merret parasysh edhe projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për RTK-në, i hartuar në legjislaturën e kaluar.

**Shqipe Pantina**, kundërshtoi që për hartimin e draftit të merret parasysh drafti i hartuar nga komisioni i legjislaturës së kaluar. Ajo kërkoi që në projektligj të inkorporohet një nen që përcakton se RTK-ja të auditohet, përveç auditorit të pavarur, edhe nga auditori përgjithshëm i Kosovës.

**Albert Kinolli**, mbi bazë të arsyes, që RTK duhet shikuar si medium i qytetarëve, pa dallim, propozoi që si model të merret Ligji i transmetuesit publik të Sllovenisë.

**Imet Rrahmani**, propozoi të caktohet agjenda për hartimin e draft-ligjit, në kontekstin e kohës.

### **3. Të ndryshme**

Komisioni vendosi që për mbledhjen e radhës të ftohet ministri i MAP-së, z. Mahir Yagcilar, për të raportuar për reformën në administratën publike.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

**E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

-----

Nait Hasani